

RELACION TEKNIK

MBI PUNIMET GJEODEZIKE DHE TOPOGRAFIKE

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin: Ndertimi i rruges se re nga Rrotondo e Varrezave deri ne intersektimin e rruges Nos Josifi .U kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori. Sektori dhe Azhornimit Topografik organizoj punen dhe kreu punimet ne baze te pervojes se perfituar ne punimet e meparshme te kesaj natyre. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme haitografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese.

Per te siguruar lidhjen gjeodezike unike te te gjitha projekteve nga firma u shfrytezuan te dhenat gjeodezike te njetit shteteror me sistemin nderkombetar te projeksionit (UTM) me ellipsoid WGS84 dhe kuota. Para fillimit te rilevimit u krye njohja e detajuar e terrenit, e cila sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes, menyren e ndertimit te njetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit teknik si dhe organizimit te punes.

Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e triangulacionit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne terren. Pikat e fiksuara ne terren u pajisen me koordinata ne projeksionin UTM ellipsoid WGS84 dhe kuota .

Fiksimi ne terren i pikave te rilevimit u krye me kunja hekuri me gjatesi 30 - 40 cm te futur toke. Ato jane vendosur ne vende te dukshme dhe te pa levizshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje blu te shkrajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te rruges ose afer saj, kane pamje te ndersjellte, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit te Rruges dhe ne ate te zbatimit te saj.

Cdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat te saj, si dhe lartesine te perftuar nepermjet nivelimit gjeometrik e gjeodezik (shih planimetrit e objekteve ku gjenden koordinatat tre dimensionale te pikave mbeshtetese). Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Pikat fikse te terrenit jane te percaktuara ne planimetrine e rruges ekzistuese te projektit. Matjet u kryen me mates GPS "SinoGNSS".


Rilevimi i brezit

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise dhe te nivelimit gjeometrik u zhvillua rrjeti i matjeve topografike te planimetrise ne objektin: Ndertimi i rruges se re nga Rrotondo e Varrezave deri ne intersektimin e rruges Nos Josifi. Ne percaktimin e relievit jemi bazuar kryesisht ne zonat ku kane ndryshime te terrenit ekzistues ne perputhja me kerkesat e pergjitheshme dhe specifike teknike te hartimit te projektit.

Eshte rilevuar cdo objekt ne afersi te zones si rruge, skarpatet anesore, ndertesa, mure, mure mbajtes, gardhe, objekte te ndryshem, shtylla tensioni etj. Objektet e pare ne terren jane hedhur ne relief te gjithe. Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Cdo pike e mare ne terren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin AUTOCAD CIVIL & PLATEIA CGS 2009 . Ky relief sherbeu per hartimin e projektit te zbatimit me saktesine dhe cilesine e kerkuar ne termat e references nga investitori.

Ne materialin grafik te projektit jepet planimetria e fiksimeve dhe tabela e koordinatave te pikave te vendosura ne terren.



Pershkrimi i punes ne terren.

Per mbeshtetjen e punimeve fillimisht u krijuan 2 pika te forta te cilat jane te mjaftueshme per kryerjen e pikave detaje te rilevimit .

Rilevimi i trupit te rruges egzistuese si dhe te gjithe elementeve me largesi rreth 30 m nga aksi.

Grupi Punes

Pergjegjes S.A.T: ing. Elier Mihali



Drejtori D.P.U-se
Ark. Marvis AVLLAZAGAJ



